



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORË
TEATRI "PETRO MARKO"

Nr. _____ prot.

Vlorë, më _____ 2024

Lënda: Kërkesë informimi

**KOMISIONERIT PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT
DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE**
Rruga" Abdi Toptani", Nd.5
Tiranë

Për dijeni: QËNDRËS "RES PUBLICA"
Bulevardi "Gjergj Fishta", Nd.24, H3, Ap.7,
Tiranë

Referuar kërkesës me Nr.prot .96/24 datë 29.05.2024, me kërkues Qendra "Res Publica", dhe tuajës me Nr.1668/I prot., datë 05.07.2024, në lidhje me kërkesën për informim ju vëmë në dispozicion informacionin sa më poshtë vijon:

- Buxheti total për vitin 2024 , miratuar për Teatrin "Petro Marko" Vlorë është në vlerën 43.305.000 (Dyzetë e tre milion e treqind e pesëmijë Lekë). nga te cilat :
- 28.945.000 (Njëzetë e tetëmilion e nentëqind e dyzetë e pesëmijë Lekë) për fondin e pagave, 10.860.000 (dhjetëmilion e tetëqind e gjashtëdhjetëmijë Lekë) për shpenzime operationale (nga keto 500.000 (Peseqind mijë leke) parashikuar për projekte në bashkëfinancim me Bashkinë Vlorë) dhe 3.500.000 , fondi i parashikuar për investime në ndërtesë dhe pajisje zyre.
- Në vitin 2022 janë prodhuar 7 shfaqje, ne vitin 2023 jane prodhuar 7 shfaqje dhe për vitin 2024 janë parashikuar 8 shfaqje (nga të cilat 4 projekte bashkëfinancim me Bashkinë Vlorë)
- Gjatë vitit 2022 jane realizuar 7 shfaqje:
 1. "Autobusi Rrangall", drame nga Tennessee Williams, regji të Niko Ilia, shitur 541 bileta.

2. "Darka e të marrëve", komedi nga Francis Veber, me regji të Roland Minga, shitur 679 bileta.
 3. Spektakli i talenteve të reja "Fest Art 2022", organizuar me ftesa (pa bileta)
 4. Recitali i këngëtarit solist të Teatrit "Petro Marko", organizuar me ftesa (pa bileta)
 5. "Show veror 2022", spektaklet verore me humor, këngë e kërcime moderne, për pushuesit, organizuar në sheshe të ndryshme në qytet gjatë muajve Korrik-Gusht. (pa bileta)
 6. Mbrëmje Gala "60 vjet Teatër", organizuar, me rastin e 60-vjetorit të Teatrit "Petro Marko" me të ftuar artistë të mirënjohur shqiptarë. (me ftesa)
 7. "Mbrëmje Gala e Fudvitit 2022", koncert festiv me pjesëmarrjen e Orkestrës së Universitetit të Arteve, tenorë, soprano dhe 5 solistë orkestrantë të njohur. (me ftesa)
- Gjatë vitit 2023 realizuar 7 shfaqje:
 1. Komedia e trishtë "Profesionisti", autor Dusan Kovacevic, regji të Leka Bungo, shitur 884 bileta.
 2. "Vrasje në Paris", komedi nga Eugene Labiche, regji Laert Vasili, shitur 260 bileta.
 3. Spektakli i talenteve të reja "Fest Art 2023", shitur 676 bileta
 4. "Show veror 2023", spektaklet verore me humor, këngë e kërcime moderne, për pushuesit, organizuar në sheshe të ndryshme në qytet gjatë muajve Korrik-Gusht. (pa bileta)
 5. Komedia "Dëshira e trete", me autor Ferdinand Hysi, regji të Roland Minga, shitur 605 bileta.
 6. Mbrëmja poetike "Nuk do të bjere shi pergjithmone", ideuar dhe interpretuar nga aktori Kudret Alikaj, shoqëruar në piano nga Rakela Latifi. (me ftesa)
 7. "Mbrëmje Gala Fundvit 2023", me pjesëmarrjen e kolosëve të muzikës dhe skenës shqiptare. (me ftesa)

Konceptoi: *A. Ferraj*

DREJTOR

Sokol Toto